

VENDIM

NR. 1/7, DATË 14.07.2017
I

ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "BIG MEDRESEJA" SHPK

Ortaku i vetëm i shoqërisë "Big Medreseja" shpk, i mbledhur sot, më datë 14.07.2017, në selinë e saj, në adresën *Rruga e Dibrës, Tiranë*, **Z. Vullnet Sinaj**, në lidhje me zbatimin e nenit 70 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit;

V E N D O S I:

1. Te transferojë kuotat e zotëruara prej tij në këtë shoqëri te personi i besuar Znj. Elona Koshi (Budini) e bija e Tekiut, e dtl. 04.09.1986, lindur në Gramsh dhe banuese në Tiranë Rruga "3 Dëshmorët", Yzberisht, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. 033400499 datë 06.06.2017, me të drejta dhe detyrime sipas marrëveshjes.
2. Z. Vullnet Sinaj, nga ky moment, bëhet zotëruar pasiv i kuotave (aksioneve) të tij në këtë shoqëri.
3. Shoqëria nuk do të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre, me qëllim zbatimin me korrektësi të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
4. Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë dhe kompetencë për të nënshkruar kontrata apo çdo lloji marrëveshje që, në një mënyrë apo tjetër, ka lidhje me veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKU I VETEM
Vullnet SINAJ

